



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3139/2 Prot.

Pogradec, më 15 . 07 2021

VENDIM

NR. 67 , DATË 14 . 07 . 2021

PËR
RISHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC
NR. 58, DATË 14.06.2021, "PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR SHITJEN ME
ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT "POGRADECI" SH.A,
ME NIPT: M03707601D, NË MASËN 100 %.

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "**Koncepti i autonomisë vendore**" dhe nenit 4 "**Rëndësia e autonomisë vendore**" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, shkronjës "e" të nenit 54, shkronjës "i" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 8 të Ligjit Nr. 105/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 79/2017 "Për sportin", Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 4 të Ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar, Ligjit Nr.9879, datë 21.2.2008, "Për titujt", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të bashkisë Pogradec Nr. 28, datë 01.03.2019 "Për themelimin e shoqërisë "POGRADECI F.K sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", dhe Vendimit Nr.29, datë 01.03.2019, "Per miratimin e statutit të shoqërisë "POGRADECI F.K sh.a", si dhe në bazë të shkresës Nr. 548/2 prot, datë 25.06.2021, të Prefektit të Qarkut Korçë "Mbi bazueshmerine ligjore te akteve të Këshillit", për arsye se pretendimet e moskonfirmimit të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec nr. 58, datë 14.06.2021, "Për dhënie e pëlqimit për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të futbollit "POGRADECI" sh.a, me NIPT: M03707601D, në masën 100 %", **cënojnë interesa të bashkisë, bashkësisë dhe autonomisë vendore**, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Të lerë në fuqi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pogradec nr. 58, datë 14.06.2021, "Për dhënie e pëlqimit për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të futbollit "POGRADECI" sh.a, me NIPT: M03707601D, në masën 100 %", të kthyer nga Prefekti i Qarkut Korçë, me shkresën Nr. 548/2 prot, datë 25.06.2021 dhe lëndë "Mbi bazueshmerine ligjore te akteve të Këshillit".

-
2. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
 3. Ky vendimi hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
 4. U shpall sot më datë 14.07.2021.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotirag MANGËRI

